



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-15540/22 datë: 20.06.2022



Npi – 01/182 datë: 23.06.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 23.06.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 23.06.2022 (e enjte) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje përveq Kryesuesit z.Bajram Ilazit dhe anëtarëve të Komitetit për Komunitete: Besnik Seferi, Shkurte Mustafa, Rrezartë Ramadani, Muhamet Mehmeti, Shkurte Behluli, Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Përgjegjësi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim z.Ibrahim Demiri; dhe Praktikantja, znj.Valmira Hoxha.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK më 27.05.2022 (Pikë Shtesë)
2. Propozim-Plani i punës të KPK-së për vitin 2022,
3. Diskutim për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025,
4. Diskutim për regjistrimin e nxënësve në shkollën fillore, të mesme të lartë si dhe kuotën për bursa për studentë,
5. Formimi i Komisionit për vizita në vendbanimet e komuniteteve (Shtime, Gjurmoc, Vojnoc dhe Davidoc),

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për Rendin e Ditës, propozoi edhe një pikë shtesë si pikë e par e parë “ Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK më 27.05.2022”. Arsyeja është se në momentin e nënshkrimit të ftesës për mbledhje ekstrakt procesverbal, nuk ka qenë gati, kështu që në ndërkohë sekretaria e ka punuar dhe na e ka dërguar si material shtesë, nëse Komiteti do ta aprovojë si pikë shtesë. Unë propozoj që ta fusim si pikë shtesë, në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës, me pikën shtesë “Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK më 27.05.2022”.**

Pika 1 (Pikë Shtesë)

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK më 27.05.2022

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Unë kam një vërejtje në procesverbal, sepse mungon në diskutimin tim, që kam kërkuar nga Kryetari dhe drejtoritë, që çdo projekt që ka të bëjë me komunitetet, të merren rekomandime edhe nga KPK-ja.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.05.2022.**

Pika 2

Propozim-Plani i punës të KPK-së për vitin 2022

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Zëvendës Kryesuesi, z.Muhamet Mehmeti, po kërkon që të futet edhe një pikë shtesë, për një rekomandim.

z.Besnik Seferi; Unë mendoj se ne tashmë e kemi aprovuar rendin e ditës, kështu që unë propozoj që këtë pikë të propozuar ta fusim në rendin e ditës për muajin Korrik që do të jetë së shpejti. Duke pas parasyshë përvojën e mëparshme kjo çështje e propozuar duhet të jetë si pikë e veçantë e rendit të ditës.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, unë harrova për me i thënë Kryesuesit për me e vendosë këtë qështje si pikë shtesë të rendit të ditës. Sido që të jetë ne marrim vendim.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Unë po them se nuk është larg 5 Korriku kur do ta mbajmë mbledhjen tjetër të radhës dhe do ta fusim edhe këtë çështje në rendin e ditës.

znj.Rrezartë Ramadani; Ndoshta mundemi me diskutu për rekomandim në pikën të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Po vazhdojmë me shqyrtimin e draft-planit të punës të Komitetit për vitin 2022.

z.Besnik Seferi; Sa i përket planit të punës, ky është një plan më gjithëpërfshirës, kështu që nuk besoj që kemi diqka të shtojmë, përveq nëse del diqka në ndërkohë. Është bërë një punë e mire nga ky Komision.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Ky plan mund të shtohet vazhdimisht, nuk e kemi vendosë pikën të ndryshme.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Te Plani i punës nuk duhet të përmenden emrat, por të përmendet vetem zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit. Dhe qështja e dytë datat e mbledhjeve të KPK-së të përmendura në plan duhet të harmonizohen me datat e mbledhjeve të Kuvendit, me disa ditë përpara.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Planin e Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, me vërejtjet e z.Ibrahim Demirit.**

Pika 3

Diskutim për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, ishte dashtë të na jep fillimisht sqarime përfaqësuesi i Zyrës për Financa, por që nuk qenka prezent, ndoshta na njofton sekretaria e Kuvendit a kanë qenë të njoftuar me kohë për këtë mbledhje.

z.Idajet Rexhepi, Zyrtar i Kuvendit; Përshëndetje, po unë ftesat i dërgoj rregullisht përveq për anëtarët e Komitetit edhe për të gjithë drejtorat, e sidomos për ata drejtorë që kanë prezntimin e ndonjë pike, faktikisht njoftohet gjithë ekzekutivi i Komunës. Ftesat u dërgojmë edhe OJQ-ve që kanë shprehë interesim për të përcjellë mbledhjet e KPK-së, si dhe përfaqësuesve ndërkombëtar.

z.Besnik Seferi; Për sa i përket KAB-it, meqenëse mungon ZKF-ja ne po diskutojmë vetë, mirëpo duke pas parasysh rendësinë që ka ky document për Komunën tone, mendoj se ky document ka prioritet, sepse mendoj se ka shumë për tu diskutuar. Mendoj se do të ishte e

logjikshme që të organizohet një debat edhe me banorët e komunitetit pakicë, që sado pak hallet dhe brengat e banorëve të mund të realizohen.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Unë kisha propozuar që Kryetari me Kryesuesin të sigurojë që drejtorat të marrin pjesë në mbledhjet e KPK-së, për prezantimin e pikave që janë paraparë me plan për ta. Pastaj do kisha propozuar që të shtohet buxheti për Zyrën për Komunitete dhe Kthim.

z.Besnik Seferi; Ne 3 anëtarët e Komitetit që jemi këtu prezent e që jemi edhe anëtarë të Kuvendit e kemi m undësinë që me i paraqitë në Kuvend këto propozime. Ne duhet ta dime sakt se sa prej komunitetit pakicë kanë marrë pjesë në diskutimin publik për KAB-in. Gjërat nuk duhet të shkojnë ashtu siç kanë shkuar deri më tash.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, unë propozoj që ta bëjmë një rekomandim që në mbledhjet e radhës të KPK-së me marrë pjesë drejtorat.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Ne si anëtarë të komunitetit pakicë po kërkojmë nga ZKF-ja që të organizon diskutim publik edhe me banorët e komunitetit pakicë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht e miratoi Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2023-2025, dhe i rekomandon, Kuvendit të Komunës së Shtimes për aprovim, me vërejtjen që anëtarët e Komitetit për Komunitete që njëkohësisht janë edhe anëtarë të Kuvendit, ti paraqesin propozimet e Komitetit në mbledhjen e rregullt të Kuvendit.**

Pika 4

Diskutim për regjistrimin e nxënësve në shkollën fillore, të mesme të lartë si dhe kuotën për bursa për studentë

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Unë në fillim desha të propozoj që kjo pike të hiqet nga rendsi i ditës pikërisht për shkak të mungesës së drejtorit. Unë desha të pyes se vërtetë nuk po e kuptoj “Kuotën” çka ka dashtë me thënë me këtë. Unë mendoj se para se të shpallet konkursi për ndarjen e bursave duhet fillimisht të zgjidhet Komisioni për ndarjen e bursave. Ka qenë dashtë të jetë prezent drejtori këtu.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; “Kuota” ka qenë si masë afirmative për studentët e komunitetit pakicë.

z.Besnik Seferi; Nuk mund të caktohet asnjë “Kuotë” sepse e kemi një Rregullore për ndarjen e bursave për student që e ka miratuar Kuvendi dhe duhet të zbatohet. Nëse kërkohet futjen e ndonjë mase atëherë rregullorja duhet të ndryshohet në Kuvend për ndonjë gjë të caktuar, port ani ashtu si është duhet edhe të zbatohet. Ne mund të propozojmë që të fillohet ndryshimi i sajë.

z.Muhamet Mehmeti; Ne kemi pas një takim pune me drejtorin e Arsimit për çështjen e ndarjes së bursave dhe kam pritë për me ardhur në mbledhje, me i diskutuar këto çështje, sepse siç e dini edhe për shkak të kushteve ekonomike e sociale e kemi një nivel të ulët të arsimit edhe te komuniteti pakicë. Unë pres që herën tjetër ne si Komitet të propozojmë për me u përfshi një përparësi sepse nuk ka shumë student janë vetëm 3 nga komuniteti pakicë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Nuk mundemi me u thirrë në kritere të veqanta për komunitetin pakicë. Ne duhet të bëjmë përpjekje që tua sçarojmë ose më mire me thënë tua përkuqtojmë drejtorive obligimet e tyre, karshi projekteve që kanë impakt edhe te banorët e komuniteteve pakicë. Nuk ka mundësi që të caktohet një “Kuotë” e caktuar, dhe të themi kaq është për komunitetin pakicë dhe fund. Forma më e mire është bashkëpunimi me drejtoritë.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Shumë më e mire është masa afirmative për komunitetin pakicë.

z.Besnik Seferi; Ndryshimi i rregullores e ka një procedure të caktuar, siç është formimi i Komisionit, hartimi i draftit, diskutimi publik etj. Sa i përket bursave për student, unë vjet kam qenë anëtarë i komisionit dhe kemi pas ndarjen e 24 bursave, mirëpo sivjet kjo është dyfishuar në 50 bursa. Ajo që mund të bëhet tani është që me i stimuluar për me aplikuar për bursa.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht i rekomandon, Kuvendit të Komunës së Shtimes, që të fillojë procedurën për ndryshimin e Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Student.**

Pika 5

Formimi i Komisionit për vizita në vendbanimet e komuniteteve (Shtime, Gjurmoc, Vojnoc dhe Davidoc)

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Unë desha të bëj pyetje se a e parasheh ligji një gjë të tillë?

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Jo ligji nuk e parasheh, por është në planin e punës të Komitetit, dhe ka qenë në planin e punës të vitit të kaluar. Unë propozoj që të gjithë anëtarët e Komitetit bashkërisht të dalim në teren për vizitë familjeve të komunitetit pakicë. Fillimisht po e qes në votim këtë e pastaj do të diskutojmë për terminin e vizitës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi që të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete, bashkërisht të bëjnë vizita familjeve skamnore të komunitetit Ashkali e Rom në Komunën e Shtimes, më datën: 02.07.2022, (e shtunde) në ora 10:00, për t'i dëgjuar problemet dhe nevojat e tyre.**

z.Besnik Seferi; Unë propozoj që ajo ditë të jetë ditë vikendi.

znj.Shkurte Mustafa; Përshëndetje, unë propozoj që me datën 2 Korrik ditë e shtunde që të bëjmë vizitë familjeve të komunitetit pakicë.

znj.Rrezartë Ramadani; Unë propozoj, këtë të shtunde, me datën 25 Qershor.

*** Komiteti për Komunitete, me 5 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi propozimin e znj.Shkurte Mustafa, që me datën 2 Korrik ditë e shtunde të gjithë anëtarët e Komitetit të bëjnë vizitë familjeve të komunitetit pakicë.**

z.Arton Demiri; Unë propozoj që të bëhet në ora 14:00.

z.Besnik Seferi; Unë propozoj që ta lëmë në ora 10:00 sepse është koha më e përshtatshme për të gjithë, dhe do të kemi kohë më shumë në dispozicion për të vizituar më shumë familje.

*** Komiteti për Komunitete, me 1 votë "Për" me 5 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi propozimin e z.Arton Demirit që vizita të bëhet nga ora 14:00.**

*** Komiteti për Komunitete, me 5 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi propozimin e z.Besnik Seferit që vizita të bëhet nga ora 10:00.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e Komitetit e përfundoi në ora 15.33 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi